



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjja "Kongresi Lushnjës"

Tel:+355 35 22139

E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Nr. 15354 Prot

Lushnje, më 23/12/2016

**KONTRATË PËR MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE TË TENDERIT ME OBJEKT:
"Rikualifikim urban i hapësirës sportive"**

PALËT:

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Lushnje, lagija "Kongresi i Lushnjës" përfaqësuar nga Kryetari i saj **Z.Fatos Tushe**, i quajtur më poshtë "Investitori";

BASHKIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

"**ZENIT - 06**" sh.p.k Tiranë me licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit me nr. MK. 1208/8 dhe nr. Nipti K61731002D, i përfaqësuar


"**PROTOCONS**" sh.p.k Shkodër me licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit me nr. MK. 2968 dhe nr. Nipti L66706004U, përfaqësuesi, i quajtur më poshtë "Mbikëqyrësi"

Vërtetuar me Kontratën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë me nr. 14383 rep. dhe nr. 9228 kol. datë 21/12/2016 dhe me prokurën e posaçme nr. 14383/1 rep. dhe nr. 9228/1 kol. datë 21/12/2016 (përpara noterës Shpresa Gjoci);;

BAZA LIGJORE

1. Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
2. Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 659 dhe në vazhdim të Kodit Civil ; Ligjt nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3 të Këshillit të Ministrave datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar; si dhe Udhëzimit nr. 2 të Këshillit të Ministrave datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

3. Dokumentacioni i tenderit është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.



Neni 1 Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është: "Mbikëqyrje punimesh për tenderin me objekt: "Rikuvalifikim urban i hapësirës sportive".

Mbikëqyrësi i punimeve, bashkimi i shoqërive "PROTOCONS" sh.p.k me nr. Licence MK. 2968 dhe ZENIT-06 sh.p.k me nr. Licence MK. 1208/8, pasi u shpall fitues si mbikëqyrës në objektin e lartpërmendur, pranon dhe merr persipër mbikëqyrjen e punimeve në objektin: "Rikuvalifikim urban i hapësirës sportive", ku është investitor Autoriteti Kontraktor **Bashkia Lushnje** me përfaqësues Z. Fatos Tushe dhe ku sipërmarrës është shoqëria "SENKA" sh.p.k Lushnje me përfaqësues ligjor Znj. Donika Senka.

Neni 2 Çmimi i kontratës

Vlera totale e kontratës është: **15 999.6** (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtë) lekë me TVSH të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje. Pagesa do të kryhet në numrin e llogarisë bankare të mbikëqyrësit të punimeve në Bankën Kombëtare Tregtare me nr. llogarie bankare 001396817.

Neni 3 Afati


Afati është: 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me shoqërinë fituese.
Afati i kësaj kontrate është i njëjtë me afatin e zbatimit të punimeve për këtë objekt.¹

Neni 4 Kushtet e kontratës

Mbikëqyrësi gjatë gjithë veprimtarisë duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë kontratë si dhe kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 i Këshillit të Ministrave datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar; si dhe Udhëzimi nr. 2 i Këshillit të Ministrave datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Investitori merr përsipër të bëjë pagesën e kolaudatorit duke respektuar V.K.M nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i ndryshuar, në masën **15 999.6** (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtë)) lekë me TVSH.

¹ Pavarësisht sa më sipër afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.



7.6. dvojnat duotetraameto paliya

Nastav 5

Mnicháček je pomore vodního dolytu. V jeho hřebeni je výrazně zvlněno a identifikovat ho je možné dle jeho výrazného vzhledu, který je charakteristický pro všechny druhy mnicháčků. Mnicháček je pomore mohou vystřídat i jiné druhy kameneců, které mají podobnou formu a vzhled.

Na rozdíl od jiných pomorů má mnicháček vlastnosti pomoru a pomore, objektu všechny výše uvedené.

Nastav 6

Významným zněním je tato mohutná výstupnice s výškou, kterou je lze využít k odhadu délky výstuže nebo výšky výstupnice. Výška výstupnice je významnou hodnotou pro výpočet výšky výstupnice.

Nastav 7

Na rozdíl od jiných pomorů má mnicháček významnou výstupnici, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice.

Nastav 8

Mnicháček je pomore, jehož výstupnice je významnou výstupnicí, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice. Na rozdíl od jiných pomorů má mnicháček významnou výstupnici, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice.

Nastav 9

Mnicháček je pomore, jehož výstupnice je významnou výstupnicí, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice. Na rozdíl od jiných pomorů má mnicháček významnou výstupnici, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice.

Nastav 10

Mnicháček je pomore, jehož výstupnice je významnou výstupnicí, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice. Na rozdíl od jiných pomorů má mnicháček významnou výstupnici, kterou je možné využít k odhadu délky výstupnice.

Nastav 11



Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.

Neni 12

Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

Neni 13

Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigimi i gjendjes.

Neni 14

Drejtori i punimeve, me urdhër të mbikëqyrësit, prish dhe ribën me shpenzimet e sipërmarrësit, brenda periudhës së korrigimit të defekteve, punimet që rezultojnë me shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, përspejton kryerjen e punimeve tej grafikut dhe kohës normale të punës, pa asnjë kompensim, në raste të veçanta.

Neni 15

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të ndërpresë punimet për arsyet e ndikimit të kushteve klimatike në to, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit.


Neni 16

Mbikëqyrësi njofton vazhdimeshit sipërmarrësin për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit, në zbatim të kontratës së punimeve dhe gjatë kolaudimit.

Neni 17

Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërpërjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërpërje, relacionet teknike, të kërkua ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrëthanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Neni 18



Provat dhe inspektimet shtesë, që kërkojnë nga mbikëqyrësi për të verifikuar konformitetin e punimeve me projektin e specifikimet teknike, kryhen nga sipërmarrësi, sipas kushteve të kontratës.

Neni 19

Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave.
 - Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
 - Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

Neni 20

Me përfundimin e punimeve të ndërtimit, brenda 30 ditëve, zbatuesi i punimeve duhet të depozitojë në sektorin e urbanistikës një relacion në dy kopje, si dhe:

- a) çertifikatën e provave të materialeve të përdorura, lëshuar nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim;
 - b) çertifikatën për ndërtimet e paranderura;
 - c) përfundimet e provave të ngarkesës, duke bashkëlidhur aktet e mbajtura për këtë qëllim;
 - ç) dokumentet që vërtetojnë se objekti është zbatuar në përputhje me projektzbatimin, pa shmangje në drejtimet funksionale dhe statike.

Njëra nga dy kopjet e këtij relaciوني me dokumentet përkatëse ruhet përkatësish në autoritetin përkatës te planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit. Kopja tjetër merret nga mbikëqyrësi i punimeve, pasi është konfirmuar për depozitim dhe i dërgohet investitorit për kolaudim.


Neni 21

Sipërmarrësi duhet t'i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve. Me këtë rast, brenda 30 ditëve, ai i parqet mbikëqyrësit:

- a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.
 - b. Regjistrimin e kontabilitetit.
 - c. Prosesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.
 - ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
 - d. Deklaratë se objekti i cili po mbikëqyret është në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Neni 22

Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që



ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

Neni 23
Shkeljet e dispozitave ligjore

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, investitori si dhe degët e policisë së ndërtimit, kanë të drejtë të urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

Në rast se kontraktuesi kryen shkelje financiare dhe penalitete përgjigjet para ligjeve në fuqi.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo mosmarrëveshje palët duhet t'i drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e tyre.

Dispozita të fundit

Neni 25


E gjithë korrespondencia e mbikëqyrësit të punimeve me investorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe, si e tillë, ruhet me çdo kusht.

Neni 26

Kontrata përpilohet në pesë kopje: një kopje depozitohet tek Investor, një e mban Mbikëqyrësi, një tek Drejtoria e Financës pranë investorit Bashkia Lushnje, një tek Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (Bashkia Lushnjë) dhe një për dosjen e tenderit.

**INVESTITORI
BASHKIA LUSHNJE**

**KRYETARI
FATOS TUSHE**



**MBIKËQYRËSI
PËR BASHKIMIN E SHOQËRIVE
"ZENIT - 06" sh.p.k dhe "PROTOCONS" sh.p.k**

**ADMINISTRATORI I "PROTOCONS" sh.p.k
FETI DEROMEMAJ**

